



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2020:090125

Datë: 08.08.2022

Numri i dokumentit: 03307235

**P.nr.469/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICE, DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me zyrtaren ligjore Nazmije Maxhera në çështjen penale kundër të pandehurit L. M. nga fshati N.- V. të cilin e përfaqëson av.Gani Rexha, për shkak te veprës penale *Sulm* nga neni 184 par.1 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.733/20, të dt.03.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 04.08.2022, në praninë e të pandehurit L. M. mbrojtësit të tij av.Gani Rexha, të dëmtuarit V. R. e në mungesë të prokurores së shtetit po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.08.2022 e përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**IAKUZUARI: L. M.** nga i ati D., nena F., i vajzërisë M. i lindur me ..., ne fshatin N. -Vushtrri, nr.personal ..., ka te kryer shkollën e mesme, punëtor, i pa martuar, i giendjes se mesme ekonomike, shqiptar, kosovar,

### **Ë S H T Ë F A J T O R Ë**

**SEPSE:** Me dt:27.05.2020, rreth orës 19:00 në fshatin N. rr. "Z. e B.M.", V., me vetëdije ka përdorur forcën ndaj personit tjetër, në atë mënyrë qe kur i dëmtuari V. R. po i shëtiste qentë e tij të cilët kanë qenë të lidhur kular, është takuar ne L. M. i cili i është drejtuar me ton të ngritur me fjalët "Pse po kalon këndej" e pastaj të dëmtuarin e ke kapur për krahu dhe me shuplakë të hapur e ka goditur në qafë duke i thënë se nuk guxon më që të kaloj në atë rrugë,

**Me këtë ka kryer veprën penale *Sulm* nga neni 184 par.1 të KPRK-së,**

Prandaj gjykata duke u bazuar ne dispozitat e nenit 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70 dhe 184 par.1 të KPRK-së, si dhe bazuar ne nenet 365, 450, 463 dhe 497 të KPP-së e gjykon me:

### **DËNIM ME GJOBË**

**Me të cilën të pandehurit L. M.** i caktohet dënimi me gjobë në shumën prej **200€ (dyqind euro)**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mundet të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë në dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burgim, ku 1 (një) ditë burgim do të jetë e barabartë me 20 (njëzet) euro gjobë.

**OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 euro (njëzet euro)**, dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 euro (tridhjetë euro)** në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

### ***Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar***

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.733/20 të dt.03.07.2020, kundër të pandehurit L. M. nga fshati N., komuna V., të cilin e përfaqëson av.Gani Rexha, për shkak të veprës penale *Sulm* nga neni 184 par.1 të KPRK-së, duke kërkuar që në pajtim me nenin 493 të KPPK-së, gjykata të jap urdhër ndëshkimor pa mbajtje të shqyrtimit gjyqësor.

Duke vepruar sipas kërkesës së prokurorisë gjykata ndaj të pandehurit ka dhënë urdhërin ndëshkimor P.nr.469/20 të datë 12.08.2020, me të cilin e ka shpallur të pandehurin fajtorë duke e dënuar me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro. Ndaj urdhërit ndëshkimor i pandehuri përmes mbrojtësit të tij av.Gani Rexha ka paraqitur kundërshtimin e datë 20.08.2020, me të cilin ka kërkuar që ndaj të pandehurit të zhvillohet procedurë e rregullt ligjore në të cilin do të nxjerrën të gjitha provat e propozuara.

### ***Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor***

Pas marrjes së kundërshtimit gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor i cili është mbajtur me datë 04.08.2022, në të cilin kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Slavica Mavric, i pandehuri L.M., mbrojtësi i të pandehurit av.Gani Rexha si dhe i dëmtuari V. R..

Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij dhe pasi që gjykata është bindur se i njëjti e ka kuptuar aktakuzën dhe këto të drejta, si dhe i është kohë e mjaftueshme për tu konsultuar me mbrojtësin e tij, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë dhe i pandehuri ka deklaruar se **e pranon fajësinë sipas aktakuzës.**

Pas pranimit të fajësisë, gjykata i'a ka tërhequr vërejtjen të pandehurit lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë dhe të njëjtin e ka njoftuar se për veprën penale *Sulm* nga neni 184 par.1 të KPRK-së, parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në 1(një) vit, dhe se me pranim të fajësisë nuk do të mund të kundërshtoj provat apo të parashtrij prova në këtë çështje penale, se nuk mund ta atakojë vendimin e gjykatës për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por mund ta atakojë për shkak të lartësisë së dënimit dhe se deklarimin mbi pranimin e fajësisë, gjykata detyrimisht do ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese, gjithashtu gjykata paraprakisht e ka njoftuar edhe rreth benefiteve lidhur me pranimin e fajësisë.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, ka deklaruar se e ndien vetën fajtor dhe dëshiron ta pranojë fajësinë në tërësi sipas

aktakuzës duke shtuar se më asnjëherë nuk do të përsëritet ajo situatë dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, ka deklaruar se i vije keq për atë se çfarë ka ndodhur dhe se edhe tani i kërkon falje të dëmtuarit.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit mbrojtësi i të pandehurit av.Gani Rexha, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i propozon gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse pranimi i fajësisë është bërë në baza vullnetare, pa presion dhe ndikim nga jashtë dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin, e që po ashtu pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale me të cilat disponon mbrojtja. Më tutje i ka propozuar gjykatës që duke marrë parasysh pranimin “reformation in peius”, ndaj të pandehurit të shqiptoj i njëjti dënim si në urdhërin ndëshkimor, me konsideratën se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

I dëmtuari V. R. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se nuk ka se çfarë të shtoj, ai do ta shohë rrugën e tij dhe i pandehuri të vetën ashtu siç ka qenë gjithmonë. Ka shtuar se për herë të parë ka ardhur në gjykatë dhe nuk është dikush që bënë ose merret me probleme.

Prokurorja e shtetit Slavica Mavric lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se konsideron se janë plotësuar kushtet që të pandehurit ti aprovohet pranimi i fajësisë, pasi që i njëjti mbështetet në dispozitat ligjore është bërë në mënyrë vullnetare dhe mbështetur në provat e bashkangjitura në aktakuzë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka shtuar se gjykatës i propozon që me rastin e marrjes së vendimit të marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

### ***Provat e vlerësuara nga gjykata***

Gjykata pranimin e fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 326 në lidhje nenin 248 të KPPK-së, dhe ka konkluduar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimin mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe atë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-BD-395, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit – ankuesit V.R. i datës 03.06.2020, raporti i policit me numër të rastit 2020-BD-395, i datë 03.06.2020, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit L. M. i datës 03.06.2020, dhe shkresat e tjera të lëndës.

Të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklarimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

### ***Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit***

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur nga i pandehuri, dhe zotimin e tij se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm që të mos bije ndesh me ligjin, kërkim faljen e të pandehurit drejtuar të dëmtuarit në seancë dhe sjelljen korrekte të tij gjatë gjyqimit. Kurse sa iu përket rrethanave rënduese gjykata mori parasysh rrezikshmërinë e kësaj veprë penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra, ashtu që i dëmtuari është sulmuar në rrugë publike derisa ka qenë vetëm duke ecur me qentë e tij, ndërsa rrethana të tjera rënduese nuk gjeti.

Gjykata çmon se dënimi me gjobë i shqiptuar në lartësinë e njëjtë si në urdhërin ndëshkimor të datës 12.08.2022, është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale

dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, dhe se edhe me administrimin e provave në shqyrtim gjyqësor gjykata nuk gjeti se një dënim më i rëndë do ti kontribuonte qëllimit të dënimit. Ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit av.Gani Rexha, se gjykata me aktgjykim do të duhej të vendoste si në urdhërin ndëshkimor bazuar në ndalesën “Reformatio in peius”, për gjykatën ishin të pabazuara sepse në përputhje me dispozitën e nenit 497 të KPPK-së, me rastin e marrjes së aktgjykimit lidhur me kundërshtimin, gjyqtar i vetëm gjykues nuk detyrohet me kërkesën e prokurorit të shtetit nga neni 493, paragrafi 2 dhe as me ndalesën “Reformatio in peius” nga neni 395 i këtij Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Së këndejmi me pranimin e të gjitha këtyre rrethanave, e në vështrim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPPK-së, gjykata konsideroj se nuk ka pasur vend që të pandehurit t’i shqiptohet dënim më i rëndë apo më i butë. Andaj, gjykata vlerësoj se edhe me këtë dënim me gjobë ndaj të pandehurit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPPK-së dhe atë që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t’i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

***Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit***

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 450 par 2, nën par. 2.6 të KPP-së, vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 463 par.2 të KPP-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat e bazuara në nenin 365 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr. 469/20 dt. 08.08.2022**

**Zyrtarja ligjore**  
**Nazmije Maxhera**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Ferki Xhaferi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.